

FACE – Familjet dhe fëmijët në arsim është një projekt i bashkëfinancuar nga Universiteti i Cyrihut për përgatitjen e mësuesve (Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut) dhe nga Departamenti i Financave i Kantonit të Cyrihut, Zvicër.

Libri i punës FACE 1 - Forcojmë vetëbesimin dhe luajmë së bashku. Moshë 4 deri 6 vjeç

Libri i punës FACE 2 - Forcojmë vetëbesimin dhe festojmë së bashku. Moshë 7 deri 9 vjeç

Libri i punës FACE 3 - Forcojmë vetëbesimin dhe punojmë së bashku. Moshë 10 deri 12 vjeç

Autorja: Wiltrud Weidinger

Bashkautorë: Sabrina Marruncheddu, Peter Holzwarth

Grafika dhe Layout: Nadine Hugli

Redaksia: Franziska Agosti

**PH
ZH** IPE – INTERNATIONAL
PROJECTS IN
EDUCATION
ZURICH UNIVERSITY
OF TEACHER
EDUCATION

Publikuar më 2017

Universiteti i Cyrihut për përgatitjen e mësuesve, Qendra IPE.

www.phzh.ch/ipe

FACE

Wiltrud Weidinger

FORCOJMË VETËBESIMIN DHE LUAJMË SË BASHKU

Mosha 4 deri 6 vjeç



PËRMBAJTJA

1 Ky/kjo jam unë Faqe 7–20

1 – Detyra 1	Ky-kjo jam unë	10
1 – Detyra 2	Mua më pëlqejnë kafshët	12
1 – Detyra 3	Unë jam unë – ti je ti	14
1 – Detyra 4	Kjo më bën të qesh	15
1 – Detyrë familjare 5	Maska qesharake kafshësh	17
1 – Detyra 6	Ne praktikojmë lojërat tona	20

2 Klasa ime Faqe 21–36

2 – Detyra 1	Kush është në klasën time?	24
2 – Detyra 2	Mua më pëlqen klasa ime	27
2 – Detyra 3	Le të luajmë në kopsht	30
2 – Detyra 4	Ne ndërtojmë kopshtin e fantazisë sonë	32
2 – Detyrë familjare 5	Jemi të gjithë njëloj-jemi të gjithë të ndryshëm	34
2 – Detyra 6	Është argëtuese të luash në kopsht	36

3 Si të jemi shokë Faqe 37–50

3 – Detyra 1	Shokët janë të rëndësishëm	40
3 – Detyra 2	Si ndihesh sot?	43
3 – Detyra 3	Tregoj ndjenjat e mia	45
3 – Detyra 4	Le të bëjmë paqe	46
3 – Detyrë familjare 5	Një shenjë miqësie	48
3 – Detyra 6	Le të luajmë sërish	50

4 Jam i shëndetshëm Faqe 51–64

4 – Detyra 1	I them faleminderit trupit tim	54
4 – Detyra 2	Shqisat e mia	56
4 – Detyra 3	I shëndetshëm dhe jo i shëndetshëm	58
4 – Detyra 4	Vizatoj ushqimin tim të parapëlqyer	60
4 – Detyrë familjare 5	Më pëlqen shija e...	62
4 – Detyra 6	Le të luajmë sërish	64

5 Çfarë mund të bëj Faqe 65–78

5 – Detyra 1	Mund të bëj shumë gjëra	68
5 – Detyra 2	Mund të bëj muzikë	71
5 – Detyra 3	Gurët e mi të bukur	73
5 – Detyra 4	Mund të zgjidh një problem	75
5 – Detyrë familjare 5	Ne bëjmë një kometë	77
5 – Detyra 6	Ne praktikojmë lojërat tona	78

6 Ne luajmë së bashku Faqe 79–92

6 - Detyra 1	Të përgatiturit e festës së lojërave	82
6 - Detyra 2	Prova	85
6 - Detyra 3	Ne përgatisim ftesën	87
6 - Detyra 4	Praktikojmë (1)	89
6 - Detyra 5	Praktikojmë (2)	91
6 - Detyrë familjare 6	Festa e lojërave: Luajmë së bashku	92

7 Çfarë kam mësuar unë – çfarë kemi mësuar ne Faqe 93–103

7 - Detyra 1	Na pëlqen ta lëvizim trupin tonë	94
7 - Detyra 2	Të vizatuarit e një çmimi për trupin tonë	96
7 - Detyra 3	Piktura e klasës sonë	98
7 - Detyra 4	Kështu përsëhendesin marsianët	99
7 - Detyrë familjare 5	Përshtypjet e prindërve të mi	100
7 - Detyra 6	Çfarë më pëlqeu dhe çfarë nuk më pëlqeu	102

Përshtypjet e mësuesit tim		104
----------------------------	--	-----



LOJËRAT



Lojëra aktivizuese me të cilat fillon mësimi

	Faqe
Bëjmë ëmbëlsira	75
Kllapi	73
Çfarë është e kuqe?	30
Çfarë është ndryshe?	27
Fut topat në kuti (2-Detyra 3)	30
Guri "rruzull" (5-Detyra 3)	73
Gjarpri muzikor	32
Hedhja e kometës	77
Rrëzim i kanaqeve (2-Detyra-3)	30
Kryet dhe supet (7-Detyra 1)	94
Kush është ulur afër meje?	10
Kush nga ju mundet?	71
Loja e përshëndetjeve	10
Mamaja dhe kotelet	12
Mos qeshni	15
Përshëndetjet e Marsit (7-Detyra 4)	99
Përplas shuplakat mbi dysheme	56
Program palestres për ndjenjat (3-Detyra 3)	45
Raketa niset	68
Robotët dhe mekanikët	48
Pista e verbër	40
Sallatë frutash	58
Simoni thotë	68
Skulptori dhe të skulpturuarit	46
Stuhia	34
Bëhu pasqyra ime	14
Vezë e prishur	60
Zërat e kafshëve	17



Lojëra qetësuese që mbyllin mësimin

	Faqe
Çfarë ka ndryshuar?	71
Çfarë mësova?	24
Gjeje se si ndihem	43
Hungëri derrkuc, hungëri	12
Ku është thesari?	15
Kush është ky/kjo?	34
Merimanga në rrjet	73
Mesazhi i fshehtë	48
Mirupafshim top	58
Duart e ngrohta të diellit	56
Pëshpëritje e lehtë	75
Të lash makinën	32
Të shkruash mbas shpine	14
Ulur mbi prehrin e njëri-tjetrit	40
Unë jam hija jote	27
Unë jam një kafshë	17



Punë vetëm



Punë me një apo
dy fëmijë të tjerë



Punë në grup



Koha

SI MUND TË PUNOJMË ME KËTË LIBËR

Mirë se vini në FACE – "Familje dhe fëmijë në arsim"

Ky libër vlen edhe për fëmijët edhe për mësuesit. Ai është konceptuar si libër pune për fëmijët për të përmirësuar pikat e tyre të forta dhe ndjenjat në lidhje me vetveten, si dhe një libër planifikimi dhe parapërgatitjeje për mësuesit. Mësuesit do të gjejnë 7 kapituj që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të vetëkompetencave dhe aftësitë jetike për fëmijët e moshës 4 deri në 6 vjeç. Në çdo kapitull është një detyrë lidhur me të ftuarit e prindërve në shkollë për të punuar së bashku me fëmijët.

Po ashtu çdo detyrë përfshin lojëra që do të luhen ose do të bëhen në shkollë. Listën e të gjitha lojërave e gjeni në faqen 4. Në fund të vitit shkollor do të organizohet një festë lojërash së bashku me fëmijët dhe prindërit (kapitulli 6). Kapitulli i fundit i librit jep një mundësi për reflektim të procesit të nxënies dhe ofron hapësirë për reagime si nga prindërit dhe mësuesit.

Detyrat ndryshojnë në metodat e tyre pedagogjike dhe përfshijnë të nxënit e bazuar në detyra, të nxënit në bashkëpunim apo metoda të tjera pjesëmarrëse.

Në librin FACE 1 janë dy personazhe të cilat do t'i shkojnë librit së bashku me fëmijët. Ato ndonjëherë do të tregojnë diçka në foto. Ndonjëherë ato thjesht do të jenë atje, ndërkohë që fëmijët do të punojnë në një aktivitet.

Ja ku janë:



Ky libër është shkruar për djem dhe vajza, për gra dhe burra. Në tekst fëmijëve u drejtohet me "ai" apo "ajo" si një rrugë më e mirë për të lexuar. Pra të dyja gjinitë.


Le të fillojmë! Mirë se vini tek FACE –
Familje dhe fëmijë në arsim!



KY-KJO JAM unë

1



SHËNIME



Ky-kjo jam unë

Anka

Katalini



1 - DETYRA 1

KY-KJO JAM UNË

HAPAT

1. Fëmijët janë të ulur në bankat e tyre. Shpërndaji fletët e punës dhe prezantoji Ankën dhe Katalinin. Lëri fëmijët të përshkruajnë vizatimin. → Faqe 9
2. Përshkruaje figurën bosh në fletën e punës.
3. Fëmijët të ngjyrosin vizatimin dhe të vizatojnë një fytyrë dhe rroba. Kur të kenë përfunduar, të shohin vizatimet e njëri-tjetrit dhe t'i kalojnë nëpër klasë.
4. Fëmijët kthehen në rrethin e karrigeve. Ata prezatojnë vizatimet e tyre duke treguar shkurt për veten. "Ky-kjo jam unë. Emri im është... Unë kam... (flokë kafe, sy blu, pantallona të gjera të bukura etj.)" Mësuesi i bën që ata të zgjedhin një gjë për të thënë. Më pas të gjithë fëmijët përsërisin: "Kjo është... Ajo ka... Të lumtë, (emri)!" Të gjithë fëmijët duartrokin, kështu çdo fëmijë merr një duatrokitje.



45'

Detyra:

Ti përshkruan veten dhe luan me të tjerët. Vizaton veten. Njihesh me emrat e shokëve të tu.

Si punon:

Me të gjithë grupin, vetëm

Materiali:

- Fletët e punës → Faqe 11
- Lapsa me ngjyra



• LOJA E PËRSHËNDETJEVE


Fëmijët lëvizin nëpër klasë. Shoqërohet me muzikë. Kur muzika ndalon, fëmijët duhet të ndalojnë dhe të përshëndesin njëri-tjetrin duke shtrënguar duart, së bashku duartrokin, bëjnë qepalla, përdorin vetëm gishtin e vogël, prekin hundët e njëri-tjetrit etj. Ata thonë: "Emri im është...". Mësuesi u tregon fëmijëve se si duhet të përshëndesin njëri-tjetrin, përpara se të fillojë muzika.

• KUSH ËSHTË ULUR AFËR MEJE?

Të gjithë fëmijët janë të ulur në rrethin e karrigeve: Një karrige është bosh. Fëmija që është ulur në të majtë të karriges bosh fillon me frazën pasuese. "Vendi në të djathtën time është i lirë, dëshiroj që... të vijë tek unë." Fëmija që thirret, vjen dhe ulet pranë fëmijës së parë. Më pas fëmija i ulur në të majtë të karriges bosh fillon. Mësuesi duhet të jetë i sigurt se nuk janë të njëjtit fëmijë që zgjedhen për të ndryshuar karrigen.



Ky-kjo jam unë



Ky-kjo jam unë:

Blank light blue rectangular box for writing the answer.

1 - DETYRA 2

MUA MË PËLQENJË KAFSHËT

HAPAT

1. Fëmijët rrinë në karriget e tyre. Mësuesi i pyet: "Kush i pëlqen macet dhe kotelet?" Fëmijët ngrejné duart. Mësuesi gjen edhe shembuj të tjerë (qen, elefantë, tigma, balena, delfinë, kuaj etj.)
2. Tregon fletët e punës: "Cilën kafshë pëlqen Anka dhe Katalini?" Fëmijët i përshkruajnë dhe i emërtojnë kafshët.
3. Fëmijët ngjyrosin njëren prej kafshëve që pëlqejné dhe punojné vetë.
4. Kur fëmijët të kenë përfunduar, vijnë sërish në rreth me fletët e tyre të punës. Mësuesi i pyet: "Cili pëlqen...?" Fëmijët që kanë ngjyrosur atë kafshë, ngrejné duart. Mësuesi bën disa prej këtyre pyetjeve.



45'

Detyra:

U tregon të tjerëve se çfarë të pëlqen. E kupton se çdokush është ndryshe.

Si punon:

Me gjithë grupin, vetëm

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 13
- Lapsa me ngjyra



• **LOJA E PËRSHËNDETJEVE** → Faqe 10

• **KUSH ËSHTË ULUR AFËR MEJE?** → Faqe 10

• **MAMAJA DHE KOTELET**


Një fëmijë është macja-mama dhe pret në qoshe të klasës. Në qoshen tjetër fëmijët (ose mësuesi) cakton një fëmijë të jetë kotelja. Të gjithë fëmijët lëvizin si mace nëpër klasë. Herë pas here kotelja thotë: "mjau". Mamaja duhet ta gjejë kotelen. Ajo tregon kur e gjen atë. Më pas një fëmijë tjetër mund të bëhet mama.



• **HUNGËRI DERRKUC, HUNGËRI**

Fëmijët rrinë sërish ulur në rreth. Mësuesi zgjedh një fëmijë të jetë "fermeri". Të gjithë fëmijët e tjerë janë derrkucë. Fermeri është me sy të lidhur dhe qëndron në mes. Më pas fermeri silllet përreth tri herë dhe ecën symbyllur. Fermeri ulet në prehrin e derrkucit dhe thotë: "Hungëri derrkuc, hungëri" Kur derrkuci hungërin, fermeri duhet të gjejë emrin e fëmijës. Nëse fermeri e gjen saktësisht, derrkuci bëhet fermer radhën tjetër. Nëse jo, fermeri duhet të silllet sërish përreth dhe të ulet në prehrin e një derrkuci tjetër.

Mua më pëlqejnë kafshët



1 - DETYRA 3 unë JAM unë - TI JE TI

HAPAT

1. Mësuesi tregon p.sh.: "Anka dhe Katalini janë fëmijë shumë të veçantë. Ata mund të bëjnë shumë gjëra. Atyre u pëlqejnë kafshët, u pëlqen kopshti, u pëlqen të luajnë me fëmijë të tjerë. Gjithashtu dëshirojnë të jenë unikë. A e dini se çdo të thotë unik?" Një diskutim në lidhje me të qenit unik bëhet. Mësuesi shpjegon se pse shenjat e gishtërinjve janë unike.
2. Fëmijët rrinë në grup katërsht dhe mbi mesin e fletës së bardhë lënë shenjat e duarve.
3. Kur fletët të jenë tharë, fëmijët kthehen në bankat e tyre dhe bëjnë lule me shenjat e duarve të tyre.
4. Lulet ekspozohen në klasë. Ato i shikojnë të gjithë. A janë ato njësoj? A ndryshojnë? Mësuesi drejton diskutimin.



45'

Detyra:

Ti kupton që je unik dhe shokët e tu janë unikë.

Si punon:

Me të gjithë grupin, me një shok

Materiali:

- Ngjyra dhe bojë
- Fletë të bardha



• KUSH ËSHTË ULUR PRANË MEJE? → Faqe 10

• BËHU PASQYRA IME

Dy fëmijë qëndrojnë përballë njëri-tjetrit. Një fëmijë fillon të lëvizë (p.sh. përplas duart apo ngul këmbët.) Fëmija tjetër duhet të jetë pasqyra dhe bën të njëjtën gjë. Më pas fëmija i parë bën një lëvizje ndryshe. Pasqyra duhet të bëjë të njëjtën gjë. Pas disa herësh, mësuesi u thotë fëmijëve të ndërrojnë rolet. Tashmë fëmija tjetër është pasqyra.



• TË SHKRUASH MBAS SHPINË

Dy fëmijë luajnë së bashku. Njëri prej tyre rri ulur përballë tjetrit. Fëmija e parë fillon të vizatojë diçka në kurrizin e fëmijës tjetër (p.sh. një zemër, rreth, trekëndësh etj.) Fëmija tjetër gjen se çfarë ai vizaton. Më pas ndërrojnë rolet.

1 - Detyra 4

Kjo më bën të qesh



30'

Detyra:

Gjen se ç'gjë të bën të qeshësh.
Bën të tjerët të qeshin.
E kupton që të qeshurit bashkë
krijon një atmosferë të mirë.

Si punon:

Me të gjithë grupin, me një shok,
vetëm

Materiali:

- Fleta e punës → Faqe 16
- Lapsa me ngjyra

HAPAT

1. Të gjithë fëmijët rrinë në rreth. Mësuesi fillon të diskutojë me ta se për ç'gjë ata qeshin. Mësuesi përdor pyetje të hapura dhe me përgjigje të shkurtra. Fëmijët përgjigjen dhe mësuesi duhet të sigurohet që secili ta ketë radhën.
2. Më pas mësuesi bën pyetje:
 - A i njihni mënyrat e ndryshme të të qeshurit? Fëmijët mund t'i provojnë ato.
 - A njihni ju ecje të ndryshme qesharake? Fëmijët mund t'i provojnë ato.
 - A dini ndonjë këngë për të qeshur? Një fëmijë apo gjithë klasa mund ta këndojë atë. Mësuesi duhet të sigurohet që gjuha është parësore.
3. Më pas mësuesi vazhdon: "A mund të qeshni me të vërtetë për gjithçka?" Ai dëgjon përgjigjet e fëmijëve.
4. Më pas: "Ne duhet të bëjmë një ushtrim bashkë" Fëmijët shkojnë në bankat e tyre dhe punojnë me letra.



- **BËHU PASQYRA IME** → Faqe 14

MOS QESHNI



Gjithmonë rrinë përballë njëri-tjetrit.
Kush mund të qëndrojë më gjatë
pa qeshur? Është më e vështirë kur
të dy fëmijët fillojnë të bëjnë fytyrë
qesharake.



KU ËSHTË THESARI?

Fëmijët qëndrojnë në rreth, ngjitur
njëri me tjetrin. Duart e tyre janë
mbrapa. Një fëmijë është në mes
të rrethit dhe ai/a jo mbyll sytë.
Mësuesi i jep njërit prej fëmijëve
në rreth një thesar (çelësa, top etj.).
Fëmija në mes të rrethit hap sytë.
Fëmija tjetër pason thesarin nga
mbrapa tek tjetri e kështu me radhë
pa bërë shumë zhurmë. Fëmija në
mes duhet të gjejë dhe të fiksojë
ku është thesari. Kur gjetja është
saktë, fëmijës që iu gjet thesari,
shkon në mes të rrethit.

Kjo më bën të qesh!



1 - DETYRË FAMILJARE 5

MASKA QESHARAKE KAFSHËSH



Detyra:

Bën një maskë qesharake të kafshës.

Si punon:

Vetëm, në grup, bashkë me mësuesin dhe prindërit

Materiali:

- Letër
- Bojë



ZËRAT E KAFSHËVE

Fëmijët rrinë në rreth. Njëri është në mes të rrethit dhe mban një top. Ai hedh topin tek një fëmijë tjetër dhe thotë emrin e një kafshe. Fëmija i rrethit duhet të bëjë zërin e kafshës. Nëse nuk e bën zërin e kafshës ndërron vend me fëmijën në mes të rrethit.



UNË JAM NJË KAFSHË



Mësuesi i hedh një top të lehtë njërit prej fëmijëve. Fëmija flet për veten p.sh. Unë jam një tigër komik. Emri im është...(Fëmija mund të shpikë emra ose të thotë emrin e vet.). Ai gjithashtu mund të bëjë një zë. Fëmija mund të lëvizë nëpër klasë dhe të pretendojë që është kafshë.

HAPAT



1. Mësuesi shpjegon maska qesharake kafshësh. Ai tregon shembuj maskash (faqja tjetër) dhe i lë fëmijët që t'i emërtojnë ato. Më pas ai i inkurajon fëmijët që të vendosin se cilën kafshë ata duan të bëjnë.
2. Mësuesi përgatit tabak letre apo karton të trashë (rreth), bojëra uji, ngjitëse dhe gjëra për të mbërthyer maskat (pendë, letër me ngjyrë, lesh etj.) Ai mund të përdorë gjithashtu modelet në faqen tjetër.
3. Fëmijët punojnë në grupe katërshe me ndihmën e prindërve.
4. Mësuesi jep udhëzimet si më poshtë. (Prindërit ndihmojnë):
 - a) Preje maskën (nëse je duke përdorur modelin).
 - b) Vizato një rreth për zgavrat e syve.
 - c) Preji sytë.
 - d) Ngjyrosi maskën.
 - e) Zbukuroje maskën.
 - f) Bëj vrima për rripin apo lidhësen e maskës.
 - g) Shkruaj emrin tënd në anën e jashtme të maskës.
5. Fëmija merr maskën e përfunduar dhe ulet në rreth bashkë me mësuesin dhe prindërit.
6. Çdo fëmijë mund të vërë maskën e tij.



Maska qesharake kafshësh



Maska qesharake kafshësh



1 - DETYRA 6

NE PRAKTIKOJMË LOJËRAT TONA



30'

Detyra:


Ti praktikon lojërat që ke luajtur.

Si punon:

Vetëm, me gjithë grupin,
me një shok

Materiali:

Varet nga loja siç përshkruhet
në detyrat: top i butë, "thesar",
maska.



• **KUSH ËSHTË ULUR
PRANË MEJE** → Faqe 10

• **LOJA E PËRSHËNDËTJEVE** → Faqe 10

• **MAMAJA DHE KOTELET** → Faqe 12

• **MOS QESHNI** → Faqe 15

• **BËHU PASQYRA IME** → Faqe 14

• **ZËRAT E KAFSHËVE** → Faqe 17



• **HUNGËRI DERRKUC,
HUNGËRI** → Faqe 17

• **KU ËSHTË THESARI?** → Faqe 15

• **TË SHKRUASH MBAS
SHPINË** → Faqe 14


• **UNË JAM NJË KAFSHË** → Faqe 17

KLASA ime

2



shënime



Klasa ime



2 – DETYRA 1

KUSH ËSHTË NË KLASËN TIME?

HAPAT

1. Mësuesi paraqet "Ankën dhe Katalinin në kopsht". Fëmijët e përshkruajnë fotografinë. → Faqe 23
2. Mësuesi tregon historinë për Ankën dhe Katalinin. Teksti në faqen tjetër mund të jetë një orientim.
3. Mësuesi bën pyetje vijuese si:
 - Çfarë ju pëlqen të luani?
 - Çfarë dini për të tjerët në klasën tuaj?
 - Kush janë shokët e tu në kopsht?
4. Mësuesi shpërndan fletët e punës dhe kalon me fëmijët fotografitë dhe pyetjet.
5. Fëmijët ecin nëpër klasë dhe pyesin fëmijët e tjerë nëse i pëlqen të luajnë futboll, të luajnë "kush e ka", të këndojnë apo të bëjnë muzikë etj. Sa herë që përgjigja është "po", ata vizatojnë një vijë të vogël nën fotografi.
6. Ata kthehen sërish në rreth.



45'

Detyra:

Ti njihesh më mirë me të tjerët.

Si punon:

Dyshe dhe me të gjithë klasën

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 26
- Lapsa me ngjyra
- Top



• HUNGËRI DERRKUC, HUNGËRI

→ Faqe 12



• ÇFARË MËSOVA

Fëmijët rrinë në rreth. Mësuesi mban topin dhe thotë "Keni gjetur gjëra të ndryshme për shokët. Dua t'u tregoni të gjithëve se çfarë keni gjetur. Nëse e merrni topin, do të tregoni diçka për veten tuaj dhe diçka që keni gjetur për dikë tjetër. P.sh. 'Mua nuk më pëlqen të luaj futboll', 'Elenës i pëlqen të këndojë', 'gjyshja dhe gjyshi im jetojnë me ne', 'Marianës i pëlqejnë mollët' etj."

HISTORI:

Anka dhe Katalini në kopsht




Anka dhe Katalini shkojnë në kopsht. Anka është pesë vjeçe dhe Katalini katër. Ata kanë një mësuese shumë të mirë. Emri i saj është Ana Ionesco. Kur fëmijët mbërrin në shkollë, secili i shtrëngon dorën mësueses dhe i thotë "përshëndetje". Më pas ata ulen në vendet e tyre. Përpara se të nisin ditën, znj. Ionesco i pyet ata se si janë. Ata të gjithë rrinë të ulur në rreth, kështu mund të shohin mirë njëri-tjetrin.

Zakonisht, ata fillojnë me një këngë apo me një lojë. Ankës i pëlqen të këndojë. Katalinit i pëlqen gjithashtu muzika, por parapëlqen të luajë lojëra. Ngandonjëherë, një apo dy fëmijë sjellin me vete në klasë diçka që e pëlqejnë. Ata ua tregojnë gjërat e tyre të parapëlqyera fëmijëve të tjerë ose tregojnë se çfarë bëjnë në kohën e lirë.

Pas kësaj, mësuesja shpesh tregon një histori nga një libër, apo ndonjëherë ata vizatojnë diçka. Gjatë pushimit, ata mund të luajnë me çfarë t'u pëlqejë. Nëse moti është i mirë, ata luajnë jashtë në oborrin e shkollës. Katalinit i pëlqen të luajë futboll me shokun e tij më të mirë, Marianin. Ngandonjëherë edhe Anka luan futboll, por asaj i parapëlqen të luajë kukafshehti ose kush e ka. Ajo është shumë e zonja për këtë, sepse vrapon shumë shpejt. Shoqja e saj më e mirë, Elena është më e gjatë se Anka dhe vrapon pak më shpejt. Të dyja vajzat luajnë shpesh me litar me shokë të tjerë. Ata janë bashkë shumë të zotët për t'u hedhur me litar.

Janë më shumë se njëzet fëmijë në klasën e Ankës dhe të Katalinit. Ata të gjithë janë shumë të mirë, por ngandonjëherë edhe grinden. Zakonisht, nuk ka asgjë serioze dhe ata janë tepër të zotët të bëjnë paqe. Nëse nuk mund të pajtohen pas një grindjeje, mësuesja përpiket t'i ndihmojë. Znj. Ionesco është shumë e prerë për këtë gjë. Ajo gjithmonë thotë që të gjithë fëmijët grinden, por është shumë e rëndësishme të mësohen se si të pajtohen.

Kush është në klasën time?



2 - DETYRA 2

MUA MË PËLQEN KLASA

HAPAT

1. Mësuesi tregon historinë (teksti në faqen tjetër) e gishtit të madh të trishtuar, duke e shoqëruar me duart e tij.
2. Mësuesi e inkurajon nxënësit të punojnë në dyshe dhe të bëjnë diçka pa përdorur gishtat e mëshenj të tyre, p.sh.
 - Zbërtheje apo mbërtheje një xhaketë.
 - Lidh këpucët.
 - Ngjyros apo shkruaj diçka etj.
3. Mësuesi bën pyetje pasuese në lidhje me historinë:
 - Pse gishtat nuk duan të luajnë më me gishtin e madh?
 - Si ndjeheshit kur shihnit gishtin e madh të qajë? Pse?
 - Çfarë mendoni për gishtërinjtë e tjerë?
 - Çfarë mendoni se na tregon historia?
4. Fëmijët marrin fletët e punës dhe lapsat me ngjyra. Ata vizatojnë fytyra të vogla në dorën bosh dhe e ngjyrosin atë.



45'

Detyra:

Ti kupton se është e rëndësishme, të ndihesh i lirshëm në klasën tënde dhe se mund të kontribuosh për një atmosferë të mirë.

Si punon:

Vetëm, dyshe, me të gjithë klasën

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 29
- Lapsa me ngjyra
- Për historinë: një pirun, laps, diçka që paraqet një pemë.



• ÇFARË ËSHTË NDRYSHE?

Dy fëmijë qëndrojnë përballë njëri-tjetrit. E shikojnë njëri-tjetrin me kujdes. Një fëmijë kthehet në klasë. Fëmija tjetër ndryshon diçka në dukje, p.sh. modelin e flokëve, rrobat, shprehjen e fytyrës etj. Fëmija tjetër duhet ta gjejë se ç'ka ndryshuar. Mësuesi jep komandën se kur mund të kthehet fëmija etj. Pas dy, tri gjetjesh, fëmijët ndryshojnë shokët.



• UNË JAM HIJA JOTE

Fëmijët luajnë dyshe dhe qëndrojnë njëri pas tjetrit. Për aq kohë sa luan muzika. Fëmija mbrapa duhet të jetë hija. D.m.th. të imitojnë të gjitha lëvizjet e fëmijës përballë. Lëvizjet duhet të imitohen sa më të sakta të jetë e mundur. Pas dy minutash fëmijët shkëmbehen.

Historia e gishtit të madh, të shkurtër, të trishtuar

Një herë e një kohë një gisht i madh i shkurtër ishte duke shëtitur në rrugën e fshatit. Kur papritmas dëgjoji dikë të qante. Ishte një gisht tjetër i madh i shkurtër i ulur në një shkëmb pranë rrugës. Ishte kaq i trishtuar, sa që gishtit të madh e të shkurtër që shëtiste, i erdhi keq për të dhe e pyeti: "Përshëndetje, gisht i madh i shkurtër. Pse po qan?"

Ende duke qarë, gishti i madh i shkurtër iu përgjigj: "Këtë mëngjes, kur doja të luaja me gishtërinjtë e tjerë, ata më thanë: Ti je i dhjamosur, i shëndoshë dhe po ashtu tepër i shkurtër. Ne nuk duam të luajmë më me ty. Unë isha shumë i trishtuar dhe vendosa të largohem. Në fillim u fsheha në xhep. Gishtat e tjerë ishin tepër të lumtur që i lashë dhe brohoritën e qeshën. Kështu i lashë krejtësisht dhe tani jam këtu, por jam kaq i trishtuar." Gishti i madh i shkurtër filloi të qajë sërish.


Gishti ynë i madh dhe i shkurtër u mendua një hop dhe më pas tha: "Mos u shqetëso, gisht i madh i shkurtër, jam i sigurt, që tashmë gishtërinjtë e tjerë e kanë kuptuar se sa i rëndësishëm je ti për ta. Eja me mua. Do të shohësh." Gishti i madh i shkurtër i trishtuar ndoqi gishtin tjetër të madh, por ishte tepër i frikësuar të shkonte tek gishtërinjtë pasues, kështu u fsheh sërish në xhep dhe i përgjonte ata. Ajo që pa ishte shumë gazmore. Gishtërinjtë ishin duke u përpjekur të merrnin pirunin për drekë, por ai u binte në dysheme. Ata u përpoqën të shkruanin një letër për një mik, por lapsi u binte në dysheme.

Kështu ata vendosën të bënin diçka gazmore. "Le të ngjisin një pemë!" thanë ata. Megjithatë kur provuan të kapeshin tek degët, rrëshqisnin. Ata filluan të fajësojnë njëri-tjetrin, sepse secili mendonte se ishte faji i gishtave të tjerë. Por atëherë ata e kuptuan se thjesht mungonte gishti i madh i shkurtër. Filluan ta thërrasin gishtin e madh të shkurtër, e t'i luteshin të kthehej: "Të lutem gisht i madh i shkurtër. Kthehu tek ne! Na mungon shumë dhe ne nuk do të të thërrasim më me emra."

Ndërkohë gishti i madh i shkurtër i kishte vëzhguar këto skena nga xhepi i tij i rehatshëm. Ishte shumë argëtuese për të të shihte se sa të ngathët ishin gishtërinjtë e tjerë pa të. Kjo e bëri atë të ndihej shumë i rëndësishëm. Kështu kur dëgjoji se gishtërinjtë po thërrisnin emrin e tij, u var nga xhepi. Të gjithë brohoritën dhe qeshën. Që nga ky moment gishti i madh i shkurtër dhe gishtërinjtë e tij miq luanin të lumtur së bashku përgjithmonë.

Përshtatur nga PH FHNW (Hg.) (2014): Mutanfälle. Mutig sich selber, anderen und der Welt begegnen. II - 3, 3. Auflage. Beratungsstelle Gesundheitsbildung: Aarau.

Gishti i madh i shkurtër
i trishtuar




2 - DETYRA 3


Le të LUAJMË në KOPSHT

HAPAT

- Mësuesi u tregon fëmijëve që ata duhet të bëjnë vetë lojërat e tyre. Për këtë gjë u nevojiten si më poshtë:
 - Një top prej gazete.
 - Letër alumini që mund ta hiqni apo ta ngjyrosni (apo top letre tualeti).
- Mësuesi ndan klasën në grupe katërshe. Çdo grupi i jep kuti kartoni. Kutitë janë të vendosura në qoshe të ndryshme të klasës. Po luhen dy lojëra:
 - Kanaçet (apo topa letre tualeti) janë të vendosura mbi tryezë. Çdo fëmijë përpiqet të rrezojë letrat e aluminit me topin prej gazete. Fëmijët mund të vizatojnë një vijë çdo herë që e fitojnë një lojë.



- Fëmijët përpiqen të fusin topat në kutinë prej kartoni. Çdo fëmijë merr të gjithë topat e grupit. Sa më shumë topa të futen në kutinë e kartonit, aq më shumë pikë fitohen.



Detyra:

Krijon lodra shumë të thjeshta me materialet e përditshme si gazete letër dhe karton.

Si punon:

Vetëm, në grup dhe me të gjithë grupin

Materiali:

- Lapsa me ngjyra
- Gazeta të vjetra
- Shirit ngjitës apo maskim
- 3-5 kuti kartoni
- Top letre tualeti, i vjetër



• ÇFARË ËSHTË E KUQE?

Fëmijët rrinë në një rreth. Një fëmijë e hedh topin tek tjetri dhe e pyet: "Çfarë është e kuqe?". Fëmija që kap topin thotë p.sh.: "Domatet janë të kuqe". Ai pyet për një ngjyrë tjetër, p.sh. "Çfarë është blu?" dhe e hedh topin tek fëmija tjetër i cili mund të thotë: "Qielli është blu". Gjatë lojës fëmijët mund të pyesin edhe për të njëjtat ngjyra, por përgjigjja duhet të jetë e ndryshme.




• KU ËSHTË THESARI?

→ Faqe 15



Ngjites

Le të luajmë në kopsht



2 – DETYRA 4

Ne ndërtojmë kopshtin e fantazisë sonë

HAPAT

1. Fëmijët rrinë ulur në rreth. Mësuesi u tregon sërish fotografinë e kopshtit. U thotë edhe një herë të shohin fotografinë dhe të gjejnë se çfarë pëlqejnë veçanërisht.
2. Mësuesi u tregon fëmijëve se çfarë do të luaj sot Anka dhe Katalini. Gjeneron historinë në faqen tjetër.
3. Ai u shpjegon se fëmijët do të "bëjnë" vetë kopshtin e tyre. Fëmijët mund të luajnë çfarë të duan. Ata lejohen të lëvizin tryezat dhe karriget. Batanijet dhe kunjat mund të shërbejnë për të ndërtuar diçka. Mësuesi gjithmonë cakton dy apo më së shumti katër fëmijë për një vend.



60'

Detyra:

Ti ndërton kopshtin e fantazisë tënde duke rregulluar tryezat dhe karriget. Luan në kopshtin "e ri".

Si punon:

Me të gjithë klasën dhe në grupe

Materiali:

- Muzikë
- Çarçafë të vjetër, batanije, kunjat etj.
- Kutitë



• GJARPRI MUZIKOR

Të gjithë fëmijët rrinë në radhë në formën e "gjarprit" të gjatë. Sapo muzika fillon, gjarpri fillon të lëvizë. Fëmija në krye të gjarprit bën lëvizje si hedhje, zvarrisje, rrëshqitje ngadalë etj. Të gjithë fëmijët e tjerë imitojnë lëvizjet. Kur muzika ndalon, fëmija që ishte në krye shkon tek bishti i gjarprit dhe është fëmija tjetër që vazhdon të prijë.



• TË LASH MAKINËN

Loja luhet duke folur shumë ngadalë. Klasa rradhitet sup më sup. Fëmija në fund të vargut është "makina" që duhet të pastrohet. Ajo zbret poshtë. Ajo lëviz poshtë rreshtit me shpinë nga rreshti. Fëmijët e tjerë janë furça. Ata fërkojnë, lagin, shkëlqejnë etj. shpinën e fëmijës. Goditja, gudulisja apo lëvizje të tjera të dhunshme nuk janë të lejueshme. Kur arrihet fundi, "makina" është pastruar dhe duhet të vazhdojë fëmija tjetër.

HISTORIA:

Anka dhe Katalini luajnë në kopsht

Sot, pas pushimit të madh, fëmijët në kopshtin e Ankës dhe Katalinit mund të zgjedhin se çfarë duan të luajnë. Anka luan dyqanesh me shokët e saj Elenën, Jonelën dhe Kostandinin. Banaku i dyqanit është i ri. Disa fëmijë të kopshtit e sajuan atë me kuti të vjetra kartoni. Ata janë shumë krenarë për të, sepse e bënë të gjithin vetë.

Elena është shitësja dhe Anka është klientja. Ajo luan një nënë e cila ka nevojë për ushqim për fëmijën. Jonela luan vajzën bebe. Ajo qan gjatë gjithë kohës dhe Anka përpiqet ta qetësojë atë. Kjo gjë merr shumë kohë dhe Kostandini që luan një klient tjetër në dyqan, po humb durimin. Ai donte të paguante e të ikën. Ata të gjithë po kënaqen tepër.

Katalini, Daniela, Mariani dhe Trajani po ndërtojnë diçka. Ata nuk bien dakort se çfarë duan të ndërtojnë me blloqet lodër. Daniela dhe Mariani duan të ndërtojnë një kala dhe të bëjnë një betejë me kalorës dhe kuaj. Por Katalinit dhe Trajanit do t'u pëlqente të ndërtonin pistë për garat e makinave.

2 - DETYRË FAMILJARE 5

JEMI TË GJITHË NJËLLOJ-JEMI TË GJITHË TË NDRYSHËM



45'

Detyra:

Rikrijon klasën tëndë duke bërë një "varg njerëzish prej letre" dhe kupton që jeni të gjithë të ndryshëm por së bashku në një komunitet.

Si punon:

Vetë, dyshe me prind, me të gjithë klasën

Materiali:

- Lapsa me ngjyra
- Gërshërë
- Ngjitëse




• **STUHIA**

Të gjithë rrinë në rreth dhe është qetësi. Mësuesi bën me zë si një stuhi që po afrohet. Fëmija majtas tij duhet të imitojë zërin e mësuesit, që përcillet nga një nxënës tek tjetri dhe sërish tek mësuesi. Mësuesi shoqëron zërat me përshkrimin e stuhisë që po afrohet. Fërkoni duart për fërshëllimën e erës, kërcit gishtërinjtë për të imituar pikat e shiut, gjuaj me pëllëmbë kofshët për të imituar rënien e shiut, përplas këmbët e tua për të imituar bubullimën dhe vetëtimën. Stuhia erdhi, është kulmi, ngadalë venitet. Bëj zërin e pjesës mbrapsht deri sa të shkëlqejë sërish dielli.

HAPAT

1. Mësuesi paraqet detyrën e bërjes prej letre të klasës. Fëmijët duhet të bëjnë një "varg njerëzish prej letre". Ai tregon se si bëhet.




2. Fëmijët me prindërit e tyre bëjnë një "varg njerëzish prej letre" dhe e ngjyrosin atë (gjithmonë dy apo katër fëmijë me një prind).
3. Kur përfundojnë vargjet, vendosen mbi tryezë apo mbërthehen në dërrasën e zezë, që të shihen nga të gjithë. Mësuesi thekson faktin që të gjithë fëmijët janë të ndryshëm, por ata i përkasin bashkësisë.



• **KUSH ËSHTË KY/KJO?**

Të gjithë qëndrojnë në një rreth. Mësuesi fillon të përshkruajë një fëmijë p.sh. "Shoh dikë që ka flokë kafe, ka veshur një pulovër të kuq dhe këpucë të bardha". Fëmija që është përshkruar ka radhën dhe përshkruan fëmijën tjetër.

Jemi të gjithë njëllorj -
jemi të gjithë të ndryshëm



2 - DETYRA 6

ËSHTË ARGËTUESE TË LUASH NË KOPSHT



45'

Detyra:


Luan disa lojëra që i njeh.
Po ashtu gjen kohë të luash lirisht
me lodrat që ke krijuar.

Si punon:

Dyshe, në grup dhe me gjithë
klasën

Materiali:

- Siç është përshkruar në detyrën
e përmendur.



- **FUT TOPAT NË KUTI** → Faqe 30
- **GJARPRI MUZIKOR** → Faqe 32
- **RRËZIM I KANAÇEVE** → Faqe 30
- **HUNGËRI DERRKUC,
HUNGËRI** → Faqe 12
- **KUSH ËSHTË KY/KJO?** → Faqe 34
- **STUHIA** → Faqe 34
- **UNË JAM HIJA JOTE** → Faqe 27




- **ÇFARË ËSHTË E KUQE?** → Faqe 30
- **ÇFARË ËSHTË NDRYSHE?** → Faqe 27
- **ÇFARË MËSOVA** → Faqe 24
- **KU ËSHTË THESARI?** → Faqe 15
- **TË LASH MAKINËN** → Faqe 32



SI TË JEMI SHOKË

3

SHËNIME



Si të jemi shokë



3 - DETYRA 1

SHOKËT JANË TË RËNDËSISHËM

HAPAT

Klasa është e ulur në rreth. Fëmijët shohin fotografinë e Ankës dhe të Katalinit duke luajtur. Ata diskutojnë për foton. → Faqe 39

1. Më pas mësuesi drejton vëmendjen në skenën me Katalinin, Marianin dhe Ankën. Mësuesi luan skenën në faqen tjetër.
2. Diskutim në lidhje me shoqërinë. Pyetje të mundshme:
 - Çfarë mendoni për sjelljen e Marianës?
 - Çfarë mendoni për sjelljen e Katalinit? Të Ankës?
 - Çfarë bën një shok i mirë?
3. Mësuesi ndan personazhet në mënyrë të barabartë në klasë. Nxënësit i presin ato. Ata edhe mund t'i ngjyrosin. Mësuesi i ndihmon për t'i ngjitur në shkopinj.
4. Në treshe luajnë skenën. Fëmijët mund të përshtatin subjektin, po të duan.
5. Disa prej grupeve mund të luajnë skenën për klasën (në rreth).



• PISTA E VERBËR

Mësuesi përgatit një pistë të vogël në klasë. Për shembull, zigzage me karrige, zvarritje nën tryezë, hedhje mbi vijë, ecje në vijë të drejtë etj. Fëmijët e bëjnë pistën në dyshe. Një fëmijë është me sy të lidhur, tjetri e çon atë përmes pistës. Mund të përdoret edhe korridor. Kjo lojë mund të luhet edhe jashtë. Pas një farë kohë, ndërrohen vendet.



60'

Detyra:

Mendon për atë që mendojnë shokët për ty dhe diskuton cili është një shok i mirë për ty.

Si punon:

Vetëm, dyshe dhe me të gjithë klasën

Materiali:

- Lapsa me ngjyra
- Gërshërë
- Ngjitëse
- Kruajtëse dhëmbësh apo shkopinj akulloresh
- Mbulesë për të mbuluar sytë në klasë



• ULUR MBI PREHRIN E NJËRI-TJETRIT

E gjithë klasa qëndron në rreth. Të gjithë fëmijët kthehen nga e djathta për të parë shpinën e fëmijës tjetër. Dhe më pas, kapen fort me njëri-tjetrin dhe kur mësuesi numëron deri në tre ata ulen mbi gjunjët e fëmijës pranë. Kur të gjithë janë ulur mbi gjunjët e njëri-tjetrit, përpiqen të ecin.



LOJË ME ROLE:
Sa më shumë, aq më argëtuese

Katalini dhe Mariani po luanin me rruzuj, kur Anka u bashkohet. Ajo qëndroi për një çast duke i parë.

Anka: A mund të luaj me ju? Jam e mirë me rruzujt.

Katalini: Sigurisht, ja: Po të jap disa nga rruzujt e mi.

Mariani: Nuk më pëlqen të luaj me vajza. Thuaj asaj të largohet, Katalin!

Katalini: Hë ore, Marian. Anka është shoqja ime. Nuk mund t'i them asaj të largohet.

Mariani: Mirë, atëherë nuk jam më shoku yt. Nuk luaj me vajza. Var buzët dhe i kthen shpinën atij.

Anka: E qeshur. Eja ore, Marian. Mos u bëj budalla. Së shpejti do ta kesh vetëm për vete Katalinin. Duhet të shkoj së shpejti në shtëpi dhe t'i ndihmoj mamit. Apo ke frikë se mos humb ndaj një vajze?






Mariani: Nuk kam frikë. Unë thjesht nuk dua të luaj me vajza. Ende buzëvarur.

Katalini: Eja ta provojmë! Do ta shohësh: Të luash me Ankën është gjë e bukur. E shtyn lehtë Marianin mënjanë. Bëje këtë për mua, shok i vjetër!

Mariani: Ngadalë duke u relaksuar me një buzëqeshje hezituese. Në rregull, mirë. Do ta provoj. Por nëse nuk është argëtuese do të ndalem.

Anka: Urra. Mund të luaj! Do ta shohësh: sa më shumë, aq më argëtuese. I gjuan Marianit në sup dhe tok duart me Katalinin.

Shokët janë të rëndësishëm



3 - DETYRA 2 SI NDIHESH SOT?



45'

Detyra:

Flet për ndjenjat e tua dhe merr kupton për ndjenjat e shokëve/shoqeve tua, gjithashtu.

Si punon:

Vetëm, dyshe dhe me gjithë klasën

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 44
- Lapsa me ngjyra
- Gërshërë
- Gjilpërë me kokë për të shtrënguar akrepin për ore

HAPAT




1. Mësuesi u tregon fotografinë e një fëmije, duke ngushëlluar një fëmijë tjetër dhe e diskuton atë me fëmijët.
2. Ai u paraqet orën e ndjenjave (shablloni). Fëmijët hamendësojnë ndjenjat.
3. Me ndihmën e orës, mësuesi u tregon fëmijëve se si ai ndihet sot. Ai përmbledh një shumëllojshmëri ndjenjash dhe lëviz akrepin e orës deri sa flet. "Sot jam i lumtur, sepse moti është i mirë dhe se ju shoh të gjithëve këtu. E dua punën dhe më pëlqen t'ju mësoj. Jam pak i mërzitur, sepse vëllai im jeton larg. Ai jeton në Itali. Gjithashtu këtë mëngjes isha pak i frikësuar sepse hasa një qen të madh në rrugë. Ai lehu dhe dukej shumë i acaruar."
4. Më pas fëmijët shkojnë tek mësuesi. Lëvizin akrepin e orës dhe thonë se si ndihen.
5. Nxënësit punojnë individualisht: Ata bëjnë orën e tyre dhe ngjyrosin emocionet e ndryshme me ngjyrat që parapëlqejnë p.sh. e verdha është lumturi, grija është trishtim, e gjelbra është krenari.
6. Një fëmijë tregon një ndjenjë në orë dhe tjetri duhet të formojë fjali me të.



• GJEJE SE SI NDIHEM

Klasa qëndron në një rreth. Mësuesi përshpërit një ndjenjë në vesh të fëmijës. Fëmija e shpreh me mimikë ndjenjën dhe tjetri duhet ta gjejë se çfarë është. Më pas është një fëmijë tjetër që bën përshpëritjen e një ndjenje në veshin e tjetrit.

Si ndiheni sot?



Ndjenja



3 – DETYRA 3

TREGOJ NDJENJAT E MIA



Detyra:

Shpreh ndjenjat nëpërmjet trupit tënd dhe mëson të njohësh ndjenjat e të tjerëve, falë lëvizjeve të tyre.

Si punon:

Me gjithë klasën

Materiali:

- Kënga "Nëse di që je i lumtur" (www.youtube.com/watch?v=D9fd4vvpRqw) apo ndonjë tjetër këngë në lidhje me lumturinë.

HAPAT

1. Mësuesi dhe fëmijët veprojnë, këndojnë dhe kërcenë këngën në lidhje me ndjenjat. Mësuesi diskuton me fëmijët se sa ndjenja të ndryshme ka dhe se si ato ndikojnë në dukjen e njerëzve dhe në lëvizjet e tyre.
2. Klasa qëndron në rreth. Mësuesi paraqet një program palestre për ndjenjat. Ai është trajner palestre, fëmijët e imitojnë. Në fillim nxënësit komentojnë se çfarë po bëjnë, dhe më pas thjesht kryejnë lëvizjet.
3. Në rreth, tashmë disa fëmijë paraqesin para gjithë klasës ndjenjat e tyre në program palestre.

NDJENJA	LËVIZJET E MUNDSHME
Jam i fortë	Qëndro në tokë me të dyja këmbët larg njëra-tjetrës. Krahët e tu janë tërelaksuar anash.
Kam frikë	Ngreji shpatullat. Hapi sytë shumë. Hape pak gojën. Vendosi duart para vetes, sikur po mbron veten.
Jam trim	Qëndro në tokë me të dyja këmbët larg njëra-tjetrës. Kurrizi është i drejtë. Vendosi duart mbi ijë.
Jam i mërzitur	Qëndro me shpatulla të rëna. Duart janë të lëshuara. Shiko në tokë.
E rehatoj veten	Vëji duart rreth vetes për t'u qetësuar.
Jam i lumtur	Ngreji duart në ajër dhe bërtit: ho-ho-ho...
Jam i inatosur	Përplas këmbët mbi shesh. Shtrëngon dhëmbët dhe shiko i inatosur. Shtrëngo grushtat.
Jam me të vërtetë i lumtur	Ngreji duart në ajër, kërcë në mënyrë të përsëritur dhe bërtit ho-ho-ho...
Jam krenar për veten	Rrehi supet vetes sepse ke bërë diçka mirë. Gjoksi i nxjerrë.

Përshtatur nga Rytz, T. et.al (2010): Papperla Pep, Körper und Gefühle im Dialog. Materialien für den Unterricht mit Kindern von 4 bis 8 Jahren. Schulverlag plus: Bern.

3 - Detyra 4 Le të bëjmë paqe



Detyra:

Diskuto pse ke argumente dhe se si mund t'i mbrosh ata.

Si punon:

Me gjithë klasën, dyshe dhe në grupe

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 47
- Letër format A4
- Gërshërë

HAPAT

1. Mësuesi paraqet fletët e punës dhe shpjegon se aty është një histori grindjeje por nuk është në renditje të duhur. Fëmijët presin fotot dhe i vendosin ato në renditje tëduhur (vetëm).
2. Mësuesi kontrollon punën. Fëmijët mund t'i ngjisin fotot mbi një copë letër.
3. Pyetjet që mund të bëjë mësuesi në diskutimin pasues:
 - Si ndihet Anka?
 - Si ndihet Katalini?
 - Pse Anka është e inatosur?
 - Pse është Katalini i inatosur?
4. Lojë me role: Fëmijët luajnë në dyshe skenën e shkurtër me zgjidhje të ndryshme në fund.
5. Disa fëmijë luajnë vullnetarisht skenën para klasës.



• SKULPTORI DHE TË SKULPTURUARIT






Një fëmijë është një bllok i papunuar mermeri, të cilit i duhet dhënë forma. Ai qëndron pa lëvizur. Fëmija tjetër është "skulptori". Hapi i parë është të krijosh skulpturën. Së pari duke prekur fëmijën dhe lëvizur/latuar ta sjellë atë në pozicionin e dëshiruar. Më pas fëmijët ndryshojnë rolet.



• TË SHKRUASH MBAS SHPINE

→ Faqe 14

Le të bëjmë paqe



3 - DETYRË FAMILJARE 5 NJË SHENJË MIQËSIE

HAPAT

1. Fëmijët rrinë ulur në një rreth. Mësuesi paraqet detyrën. Ai u demonstroi fëmijëve dhe prindërve si të bëjnë një byzylyk miqësie (përshkrimi në faqen tjetër).
2. Fëmijët punojnë në dyshe ose në grupe katërshe me një prind. Çdo fëmijë duhet të përfundojë me një byzylyk.
3. Fëmijët mund të shkëmbejnë byzylykët e tyre me një shok a shoqe ose ta mbajnë atë dhe të bëjnë një tjetër që t'ia japin.



Detyra:

Bën një byzylyk miqësie për ta dhënë si shenjë miqësie.

Si punon:

Dyshe, me prindërit dhe në grup

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 49
- Lesh apo pambuk



• ROBOTËT DHE MEKANIKËT


Mësuesi e ndan klasën në shumë robotë dhe vetëm në disa mekanikë (p.sh. 15 robotë dhe 5 mekanikë). Robotët mund të marshojnë vetëm drejt. Kur hasin një pengesë, bëjnë pip. Atëherë mekanikët duhet t'i kthejnë në anë tjetër dhe kështu ata mund të marshojnë sërish. Është detyrë e mekanikëve t'i bëjnë robotët të lëvizin dhe asnjë të mos bëjë pip.



• MESAZHI I FSHËTË

Klasa qëndron në një rreth. Mësuesi pëshpërit një mesazh në veshin e fëmijës, i cili i pëshpërit tjetrit në vesh, derisa të ketë kaluar në të gjithë klasën. Fëmija i fundit thotë mesazhin. A ishte i saktë? Pas radhës së parë, fëmijët e mendojnë një mesazh. E luajnë disa herë.





Një shenjë miqësie



BYZYLYKU I MIQËSISË

Është mund ta bësh atë

1. Merr 2 fije leshi dhe prej 50 cm të gjatë.
2. Lëre fëmijën tjetër të mbajë skajin tjetër.
3. Përdredhi të dyja fijet së bashku sa më shumë të jetë e mundur. Mos i le të të ikin.
4. Kur është shumë e dredhur, fut një gisht në mes të saj dhe paloje.
5. Fija do të lakohet.
6. Bëj një nyjë me të dyja skajet. Byzylyku është gati.



3 - DETYRA 6

Le të LUAJMË SËRISH



45'

Detyra:


Luan të gjitha lojërat sërish.

Si punon:

Vetëm, dyshe dhe në grup,
me të gjithë klasën

Materiali:

- Sikur përshkruhet tek detyra



• PROGRAMI PALESTRE PËR NDJENJAT → Faqe 45

• ROBOTËT DHE MEKANIKËT → Faqe 48

• PISTA E VERBËR → Faqe 40

• SKULPTORI DHE TË SKULPTURUARIT → Faqe 46




• GJEJE SE SI NDIHEM → Faqe 43

• MESAZHI SEKRET → Faqe 48


• ULUR MBI PREHRIN E NJËRI-TJETRIT → Faqe 40

• TË SHKRUASH MBAS SHPINË → Faqe 14


JAM I SHËNDETSHËM



shënime



Jam i shëndetshëm



4 - DETYRA 1

I THEM FALEMINDERIT TRUPIT TIM

HAPAT

1. Fëmijët qëndrojnë në rreth. Mësuesi i thotë një fëmije:
 - Të lëvizë nëpër dhomë, duke përdorur vetëm një këmbë.
 - Të duartrokasë, duke përdorur vetëm një dorë.
 - Të mbyllë sytë, të kthejë fytyrën nga dërrasa e zezë dhe të përshkruajë murin në anën e kundërt të dërrasës së zezë.

Fëmija tjetër duhet gjithashtu ta provojë. Mund ta bësh këtë?

2. Mësuesi jep udhëzime:
"Vizato një pjesë të trupit tënd që e pëlqen veçanërisht dhe mendo rreth cilësisë së saj apo aftësisë për të cilën i jeni falenderues. Paraqit vizatimin, përkëdhele pjesën e trupit dhe thuaj faleminderit asaj pjese të trupit."
3. Fëmijët e paraqesin. Fëmijët tjerë i bashkohen falënderimit të pjesës së trupit nëse u pëlqen p.sh.:
 - "Faleminderit gjuhë që je e aftë të shijosh ushqimin e shijshëm."
 - "Faleminderit dorë që më bën të aftë të vizatoj."



45'

Detyra:

Mëson të vlerësosh që trupi ta mundëson të bësh shumë gjëra.


Si punon:

Me të gjithë grupin, më pas vetëm

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 55
- Lapsa me ngjyra

I them FALEMINDERIT trupit tim



4 - DETYRA 2 SHQISAT E MIA

HAPAT

1. Mësuesi paraqet shqisat: Të parit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të prekurit dhe të shijuarit. Me shqisat e tona lidhemi me gjithë botën.
2. Nxënësit ngjyrosin shqisat dhe mendojnë veçanërisht për atë që pëlqejnë.
3. Ata provojnë shqisat e ndryshme. Mësuesi provon shqisat së bashku me fëmijët:
 - Të parit: përpiqesh të shohësh një pikturë të vogël larg.
 - Të dëgjuarit: të dëgjosh një tringëllimë shumë të ulët të ziles.
 - Të nuhaturit: të nuhasësh një parfum apo një lule.
 - Të shijuarit: të shijosh kripë apo sheqer.
 - Të prekurit: të prekësh diçka tepër të butë (gëzof, arushë pellushi etj.).
4. Fëmijët diskutojnë me njëri-tjetrin se cila është shqisa e tyre e parapëlqyer.
5. Ata vizatojnë shqisën e tyre të parapëlqyer në rreth dhe, nën këtë, një vizatim tjetër që tregon diçka që shqisa e tyre e parapëlqyer mund ose ta shohë, ta dëgjojë, ta nuhasë, ta prekë apo ta shijojë.
6. Ata shkëmbehen me një shok a shoqe.



• DUART E NGROHTA TË DIELLIT

Fëmijët qëndrojnë në rreth dhe mbyllin sytë. Mësuesi luan diellin që ngroh dhe zgjon fëmijët njërin pas tjetrit. Ai fërkon duart, që të ngrohen dhe i vendos ato me radhë mbi shpinën e fëmijëve. Kush zgjohet nga dielli ngrihet dhe shkon në bankën e vet.



45'

Detyra:

Merr dije për shqisat e ndryshme dhe çfarë na lejojnë ato për të mësuar në lidhje me botën.

Si punon:

Vetëm, më pas me një shok dhe me pas me të gjithë grupin


Materiali:

- Fletë pune → Faqe 57
- Lapsa me ngjyra
- Zile
- Parfum apo lule
- Kripë apo sheqer
- Një copë gëzof apo një arush pellushi




• PËRPLAS SHUPLAKAT MBI DYSHEME

Fëmijët gjuhëzohen mbi dysheme dhe vendosin shuplakat e duarve të tyre mbi dysheme në formën e rrethit. Çdo dorë e atij që rri pranë është midis duarve të tij dhe të shokut, pakës si zinxhir. Më pas një dorë fillon të përplas (mbi dysheme), më pas tjetra, tjetra e kështu me radhë etj. Fëmijët duhet të shohin duart e tyre dhe të atyre që rrinë afër dhe t'i koordinojnë. Pasi të jetë praktikuar për një kohë të gjatë, një aspekt i ri mund të paraqitet. Nëse një dorë përplas mbi dysheme dy herë, drejtimi duhet të ndryshojë.



Shqisat e mia



4 - DETYRA 3 I SHËNDETSHËM DHE JO I SHËNDETSHËM

HAPAT

1. Mësuesi paraqet: "Frutat janë të shëndetshme. Çfarë nuk është e shëndetshme?" Fëmijët shkëmbejnë idetë e tyre "A mund edhe ju të mendoni për gjëra që i bëni e që janë të shëndetshme apo të pashëndetshme?" Fëmijët shkëmbejnë njohuritë e tyre.
2. Më pas mësuesi vazhdon: "Hidhuni një sy pikturave në fletën e punës. Bëj një kryq tek fytyra e qeshur në fotografinë për aktivitetet e shëndetshme, bëj një kryq tek fytyra e trishtuar për aktivitetet jo të shëndetshme."
3. Më pas fëmijët krahasojnë kartat e tyre me ato të fëmijëve që janë ulur pranë.



45'

Detyra:

Disa aktivitete në jetën e përditshme janë të shëndetshme dhe disa jo. Bëhesh i vetëdijshëm për këtë aspekt.

Si punon:

Vetëm, bashkë me prindërit, me pas me të gjithë grupin

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 59
- Lapsa me ngjyra
- Top



• SALLATË FRUTASH

Fëmijët rrinë në rreth. Mësuesi cakton fruta të ndryshme tek grupet e fëmijëve (p.sh. 5 janë luleshtrydhet, 5 janë mollët, 4 janë bananet etj.). Një fëmijë është i zgjedhur të shkojë në mes të rrethit. Karrigia e tij është lëvizur nga rrethi. Tani mësuesi thërret emrat e dy frutave p.sh. luleshtrydhet dhe mollët. Fëmijët e të dy grupeve ndërrojnë vendet. Gjatë kësaj kohe, fëmija në mes përpiqet të gjejë një karrige bosh. Fëmija pa vend ka radhën të shkojë në mes të rrethit. Nëse mësuesi thërret "sallatë frutash" të gjithë fëmijët duhet të ngrihen dhe të ndërrojnë sërish karriget.




• MIRUPAFSHIM TOP


Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth. Një fëmijë ka topin. I shkel syrin një fëmijë tjetër, i hedh topin dhe i thotë: "Mirupafshim, Katalin". Katalini kap topin, i luan syrin një fëmijë tjetër dhe i hedh topin duke i thënë: "Mirupafshim, Anka!". Katalini largohet nga rrethi. Më pas fëmijët vazhdojnë. Loja përfundon kur nuk mbetet asnjë fëmijë në rreth.

I shëndetshëm dhe jo i shëndetshëm


Të bësh
sport jashtë.



Të shohësh TV
për kohë të gjatë.





Të bësh
dush.



Të hash
patate të skuqura.



Të hash
një mollë.



Të lash dhëmbët.



4 - DETYRA 4

VIZATOJ USHQIMIN TIM TË PARAPËLQYER

HAPAT

1. Mësuesi diskuton me fëmijët ushqimin e tyre të parapëlqyer.
2. Ata e vizatojnë atë mbi pjatë në fletët e tyre të punës. Punojnë vetëm.
3. Krahasojnë atë me ato të shokëve të tyre dhe gjejnë se cilat janë të njëjta.
4. Diskutojnë nëse ushqimi i tyre është i shëndetshëm apo jo. E diskutojnë këtë me shokët e tyre dhe zgjedhin se ku do të bëjnë një shenjë.



45'

Detyra:

Bëhesh i vetëdijshëm për ushqimet e tua të parapëlqyera si edhe mëson në lidhje me ushqimet e parapëlqyera të të tjerëve.

Si punon:

Vetëm, dyshe me pas me të gjithë grupin

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 61
- Lapsa me ngjyra



- **SALLATË FRUTASH** → Faqe 58



• VEZA E PRISHUR

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth. Një person (A) mund të lërë vendin e tij dhe të vrapojë përgjatë rrethit dhe të hedhë një objekt - veza e prishur - (në të vërtetë një shami apo një top prej letre) mbi një tjetër (B). B-ja duhet të reagojë sa më shpejtë të jetë e mundur dhe të vrapojë pas personit që i hodhi objektin (A-së). Nëse A-ja zihet nga B-ja, A-ja duhet ta përsërisë këtë. Nëse A-ja është i aftë të vrapojë tek vendi bosh, atëherë B-ja mbetet në rreth. B-ja duhet të vrapojë dhe të hedhë sërish një objekt.



- **MIRUPAFSHIM TOP** → Faqe 58

Vizatoj ushqimin
tim të parapëlqyer



Shumë i shëndetshëm



Jo shumë i shëndetshëm dhe
jo shumë i pashëndetshëm



Jo i shëndetshëm



4 - DETYRË FAMILJARE 5 MË PËLQEN SHIJA e...

HAPAT

1. Fëmijët rrinë në rreth. Mësuesi i pyet nëse kanë provuar të hanë ndonjëherë diçka me sy të mbyllur. Fëmijët shkëmbejnë mendimet e tyre.
2. Mësuesi u tregon se ata do të provojnë lloje të ndryshme ushqimi me sy të mbyllur.
3. Mësuesi cakton prindër në çdo grup prej katër fëmijësh. Në grupet e tyre prindërit përgatisin copa të vogla ushqimesh të ndryshme për t'u shijuar në pjatë.
4. Klasa është ndarë në grupe katërshe. Fëmijët punojnë dyshe. Njëri prej tyre mbyll sytë me një mbulesë dhe tjetri e ndihmon për të shijuar lloje të ndryshme ushqimi. P.sh. një copë mollë, një copë arre, një copë ëmbëlsire ose një kokërr rrush. Fëmijët po ashtu mund nuhasin ushqimin dhe të gjejnë se çfarë është, para se ta shijojnë.
5. Fëmijët shënojnë përvojat e tyre në fletët e punës.
6. Së fundi të gjithë fëmijët kthehen sërish në rreth. Përvoja shkëmbehet në grup:
 - A shijonte ndryshe ushqimi, kur sytë ishin të mbyllur?
 - A ka ndonjë lloj ushqimi, që doni ta hani që të ndiheni mirë?



45'

Detyra:

Mëson të përqendrosh shqisat e tua vetëm në një aspekt si dhe merr njohuri për gjërat që do dhe nuk do.

Si punon:

Dyshe, vetëm dhe me pas me të gjithë grupin

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 63
- Lapsa me ngjyra
- Copa të përgatitura ushqimesh në pjatë



• **VEZA E PRISHUR** → Faqe 60




• **KUSH ËSHTË ULUR PRANË MEJE?** → Faqe 10










• **MESAZHI I FSHEHTË** → Faqe 48

• **HUNGËRI DERRKUC, HUNGËRI** → Faqe 12

Më pëlqen shija e...

-  Çfarë ju pëlqen?
-  Çfarë është neutrale për ju?
-  Çfarë nuk ju pëlqen?



Përshtatur nga Rytz, T. (2010): Papperla PEP. Körper und Gefühle im Dialog. Materialien für den Unterricht mit Kindern von 4-8 Jahren. Schulverlag plus: Bern.

4 - DETYRA 6

Le të LUAJMË SËRISH



45'

Detyra:


Luan të gjitha lojërat sërish.

Si punon:

Vetëm, dyshe dhe në grupe, me të gjithë grupin

Materiali:

- Siç është përshkruar tek detyrat



• **KUSH ËSHTË ULUR PRANË MEJE?** → Faqe 10

• **PËRPLAS SHUPLAKAT MBI DYSHEME** → Faqe 56

• **SALLATË FRUTASH** → Faqe 58

• **VEZA E PRISHUR** → Faqe 60



• **DUART E NGROHTA TË DIELLIT** → Faqe 56

• **HUNGËRI DERRKUC, HUNGËRI** → Faqe 12

• **MESAZHI I FSHEHTË** → Faqe 48


• **MIRUPAFSHIM TOP** → Faqe 58

ÇFARË MUND TË BËJ


5



SHËNIME



Çfarë mund të bëj



5 - DETYRA 1

MUND TË BËJ SHUMË GJËRA

HAPAT

1. Mësuesi paraqet fotografinë dhe pyet fëmijët se çfarë shohin. Ata diskutojnë se çfarë mund të bëjnë Anka dhe Katalini.
→ Faqe 67
2. Mësuesi paraqet më pas fletët e punës dhe thotë: "Tani ju do të tregoni shumë gjëra që mund t'i bëni në broshurën tuaj." Ai u tregon faqet vijuese dhe ua shpjegon ato fëmijëve.
3. Fëmijët punojnë vetë dhe krahasojnë përfundimet e tyre me ato të partnerëve të tyre.



• RAKETA NISËT

Të gjithë fëmijët rrinë në një rreth. Ata janë astronautë. Raketa është nisur (duke përplasur duart e tyre me kofshët). Raketa është gati të nisët (përplasja bëhet më e shpejtë). Raketa nisët dhe ngrihet në qiell. (Fëmijët hidhen nga karriget e tyre dhe ngrenë duart). Një variant: Para nisjes mësuesi mund të numërojë bashkë me fëmijët prej dhjetë deri në zero.

• SIMONI THOTË

Të gjithë fëmijët rrinë në rreth. Mësuesi fillon të thotë: "Simoni thotë përplas duart e tua." Të gjithë fëmijët përplas duart. Mësuesi thotë: "Simoni thotë kërce lartë e poshtë." Fëmijët kërcejnë lartë e poshtë. Mësuesi thotë: "Ulu". Fëmijët qëndrojnë në këmbë. Ata duhet të bëjnë gjëra vetëm kur mësuesi fillon fjalinë me "Simoni thotë". Pastaj, disa fëmijë mund të provojnë të dirigjojnë.



Detyra:

Gjen sa më shumë gjëra që mund t'i bësh.

Si punon:

Me të gjithë grupin, vetëm, më pas me një shok

Materiali:


- Fletë pune → Faqe 69, 70
- Lapsa me ngjyra
- Top




• ÇFARË ËSHTË E KUQE? → Faqe 30

Mund të bëj shumë gjëra

Bëj një fotografi:




Sa janë këtu? Bashkoni të të saktat:



Mund të bëj shumë gjëra

Çfarë është fshehur në fotografi?
Ngjyrosi fushat me pika:



Gjej 7 ndryshime:



5 - DETYRA 2

MUND TË BËJ muzikë

HAPAT

1. Mësuesi tregon fotografinë e madhe të Ankës dhe Katalinës dhe u tregon fëmijëve se ata mund të bëjnë muzikë me shumë gjëra të ndryshme. Fëmijët shikojnë fotografinë dhe e përshkruajnë atë.
2. Stacione me instrumente të ndryshëm janë përgatitur. Jo më shumë se tre fëmijë janë në një stacion. Ata lëvizin përreth dhe gjejnë rendin se si duan ta plotësojnë aktivitetin. Ata përdorin një bllok për të shënuar se çfarë kanë bërë.
 - a) Gotë uji: Hedhni ujë në gota të ndryshme, me nivele të ndryshme uji dhe i trokisni me laps për të bërë muzikë.
 - b) Rripa gome: Përdorni rripa gome që mbështjellin një kuti për të luajtur kitare me rripa gome.
 - c) Daulle: Merrni dy shkopinj dhe gjeni se çfarë mund të përdoret si sipërfaqe daulleje.
 - d) Krehër dhe letër: Merrni një krehër, mbështillni atë me letër dhe fryeni mbi të.
 - e) Trokitje e trupit: Me cilën pjesë të trupit mund të bëni muzikë? Gojën, gishtërinjtë, duart, këmbët, gjuhën etj.?
 - f) Qese plastike: Gjeni se si mund të bëni muzikë me një qese plastike.
 - g) Rrapëllimë oriizi: Hidhni oriz apo gurë të vegjël në një kanoçe dhe rrapëlloni atë.
3. Pas një periudhe të caktuar kohe (35') mësuesi i dërgon fëmijët të ulen sërish në rreth. Ata sjellin shënimet me vete dhe tregojnë stacionet të cilat iu dukën të thjeshta, të vështira, interesante etj.



• **SIMONI THOTË** → Faqe 68



45'

Detyra:

Bën instrumente dhe muzikë me gjëra të përdorshme.

Si punon:

Me të gjithë grupin, dyshe apo treshe

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 72
- Lapsa me ngjyra
- Bojëra me ngjyra, rripa gome, shkopinj daulleje, krehra, letër e hollë, qese plastike, kuti kartoni, enë kosi, oriz, rërë.



• KUSH NGA JU MUNDËT?

Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth. Mësuesi thotë shprehjet si "Mund të luaj futboll". Të gjithë fëmijët që mund të luajnë futboll shkojnë në mes. Kur zgjedh deklaratat, mësuesi duhet të gjejë aktivitete dhe aftësi për të dyja gjinitë, djemtë dhe vajzat. Alternativë: Mësuesi mund të përdorë aftësi komike. Si shprehje të fundit mësuesi thotë: "Mund të bëj muzikë me...trupin tim/një gotë ujë etj."



• ÇFARË KA NDRYSHUAR?


Fëmijët rrinë në rreth. Të gjithë fëmijët duhet të shohin përreth dhe të ruajnë në kujtesë sa më mirë që munden, mënyrën se si janë ulur. Mësuesi zgjedh një fëmijë. Ai del nga dhoma. Tani, dy fëmijë ndërrojnë vendet e tyre në rreth. Më pas fëmija ftohet brenda në klasë. Ai duhet të shohë përreth dhe të gjejë se kush ka ndërruar vendet. Më pas një fëmijë tjetër zgjedhet që të dalë nga klasa e kështu me radhë.

Mund të bëj muzikë

Gota uji




Rripa gome




Dauille



Krehër



Trupi



Qese plastike



Rrapëllimë orizi



5 - DETYRA 3

GURËT E MI TË BUKUR

HAPAT

1. Mësuesi mban dy gurë në dorën e tij dhe u lexon një poemë fëmijëve.

Gurët e bukur

Kam tre gurë kaq të bukur dhe të rrumbullakët.

Ata nuk duken njësoj.

Ata janë të parapëlqyerit e mi që kam gjetur.

Me ta do të luajmë një lojë.

2. Mësuesi del jashtë me fëmijët për të mbledhur gurë (tre çdo fëmijë). Kur të kthehen, përgatitin ngjyrat, ujin dhe furçat. Fëmijët ngjyrosin dy gurë me të njëjtën ngjyrë. Guri i tretë ka ngjyrë ndryshe. Mësuesi shkruan emrat e tyre mbi gurë me një shënues permanent.
3. Ata luajnë lojën "Rruzull". Së pari të gjithë luajnë vetë. Guri me ngjyrë ndryshe është hedhur përballë fëmijës. Më pas dy gurët me të njëjtën ngjyrë hidhen sa më afër të jetë e mundur pranë të parit. Fëmijët luajnë dyshe. Kush fiton? Rregullat diskutohen: Jo hedhje tek fëmijët e tjerë, të hidhen vetëm disa metra larg, të mos hidhen me forcë etj.
4. Mbas lojës për rreth 15 minuta, fëmijët rrinë ulur në rreth me gurët e tyre. Ata i marrin në duar. Mësuesi reciton sërish poemën. Fëmijët e recitojnë bashkë me të.



• KUSH NGA JU MUNDET?

→ Faqe 71



60'

Detyra:

Gjen dy gurë që i pëlqen dhe i vizaton ato. Luan një lojë me të tjerët.

Si punon:

Me të gjithë grupin, vetëm dhe me një shok

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 74
- Bojëra, furça, gurë, shënues me ngjyrë të qëndrueshme, zile e vogël



• KLLAPI


Të gjithë fëmijët qëndrojnë në rreth. Mësuesi merr një kafshë të vogël të padukshme në duar. "Emri i tij është 'Kllapi'. Kllapi do të shkojë përreth dhe ju duhet ta kapni atë". Mësuesi fillon me me një duartokitje. Më pas fëmija pranë tij duartroket, më pas tjetri etj. Duartrokitja kalon nëpër rreth. Pas kësaj mësuesi duartroket dy herë. Të duartrokiturit dy herë ndryshon drejtimin e duartrokitjeve. Është qëllimi i lojës që të lihet Kllapi të lëvizë sa më gjatë të jetë e mundur.




• MERIMANGA NË RRJET

Të gjithë fëmijët rrinë në rreth. Ata janë rrjeti i merimangës. Një fëmijë rri në mes me sytë e tij të lidhur si një merimangë. Të gjithë janë të qetë. Mësuesi i jep një zile të vogël një fëmije. Fëmija hedh zilen në rreth. Merimanga duhet të zvarritet në rrjetin e vet dhe të gjejë zilen. Më pas një fëmijë tjetër është me sy të lidhur. Loja fillon sërish.

Gurët e mi të bukur



" Kam tre gurë kaq të bukur dhe të rrumbullaktë.
Ata nuk duken njësoj.
Ata janë të parapëlqyerit e mi që kam gjetur.
Me ta do të luajmë një lojë."



Emri

Emri

5 – DETYRA 4

MUND TË ZGJIDH NJË PROBLEM

HAPAT

1. Mësuesi u tregon fëmijëve një copë letër: "Çfarë mund të bësh me një copë letër?" Fëmijët japin të gjitha llojet e ideve, edhe ato shumë origjinale dhe jo të zakonshme. Mësuesi i mbledh ata në rreth.
2. Mësuesi paraqet problemin e kangurit: Anka dhe Katalini e panë këtë në kopshtin zoologjik. Ai ka lënduar këmbën e tij derisa po kërcente përreth. Tani, nuk mund të lëvizë dhe duhet të dërgohet te veterineri. Veterinari është një mjek kafshësh. Si mund ta çojnë atë tek veterineri?
3. Fëmijët vizatojnë katër mënyra të ndryshme se si mund të lëvizin kangurin.
4. Kur kanë përfunduar, mësuesi u thotë të vijnë sërish në rreth dhe të paraqesin zgjidhjet e tyre.



- **MERIMANGA NË RRJET** → Faqe 73
ose **ÇFARË KA NDRYSHUAR?** → Faqe 71

• PËSHPËRITJE E LEHTË

Fëmijët janë në rreth. Mësuesi fillon t'i pëshpëriste fjali të shkurtra në vesh të fëmijës që është ulur pranë tij. Fëmija duhet ta transmetojë mesazhin tek fëmija që është ulur pranë tij duke pëshpëritur. Mesazhi shkon nëpër rreth. Fëmija i fundit e thotë mesazhin me zë të lartë sërish. Është gazmore se si ai ndryshon. Më pas mësuesi përcakton një fëmijë të fillojë pëshpëritjen e lehtë.



Detyra:

Gjen një zgjidhje për një problem të paraqitur dhe e krahason zgjidhjen tënde me ato të fëmijëve të tjerë.

Si punon:

Me të gjithë grupin, më pas vetëm

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 76
- Lapsa me ngjyra





- **KLLAPI** → Faqe 73

• BËJMË ËMBËLSIRA

Dy fëmijë luajnë së bashku. Njëri rri ulur, tjetri qëndron mbrapa tij. Mësuesi jep udhëzime për të bërë ëmbëlsira p.sh. "Si fillim bukëpjekësi rreh brumin". Fëmija që qëndron në këmbë duhet të rrotullojë brumin me duar mbi shpinën e shokut afër. "Kur brumi është zënë, bukëpjekësi bën ëmbëlsirat. Ai përdor forma të tilla." Fëmija në këmbë vizaton forma mbi shpinën e shokut pranë. Fëmija tjetër duhet të gjejë se cila formë është. "Më pas ëmbëlsirat futen në furrë". Fëmija në këmbë vendos të dy pëllëmbët në shpinën e fëmijës tjetër dhe lëviz ëmbëlsirat. "Pas një farë kohe ëmbëlsirat janë gati. Bukëpjekësi i nxjerr ato nga furra". Fëmija hidhet mbi të.

Mund të zgjidh një problem




Përshtatur nga Shapiro, S. (2000): Thinking skills. A&C Black. London.

5 - DETYRË FAMILJARE 5

Ne bëjmë një kometë

HAPAT

1. Pas lojës me raketë mësuesi i pyet fëmijët nëse e dinë se çfarë është një kometë. Ata diskutojnë dhe mësuesi u shpjegon.
2. Fëmijët bëjnë një kometë. Ata qëndrojnë në grupe katërshe. Në çdo grup është një prind që ndihmon.
 - Çdo fëmijë merr tri fletë gazetash dhe i mbledhin bashkë si lëmshe për të bërë një top të qëndrueshëm.
 - Një litar dhe shirit ngjitës vendoset rreth topit për ta lidhur disa herë.
 - Ata mund të presin shirita prej letrash me ngjyra, copash apo qesesh plastike.
 - Shiritat janë mbërthyer tek topi me shirit ngjitës.
 - Plastikë (prej qesesh të vjetra plasmasi) vendoset rreth topit (rreth 30 cm x 30 cm).
 - Një copë shiriti, plastika është lidhur në "qafën" e kometës. Plastika e tepërt mund të pritët.
 - Prindërit ndihmojnë për të shkruar emrat e fëmijëve.
3. Hedhja e kometës: Ata të gjithë mund të dalin jashtë ndërtesës së shkollës. Fëmijët qëndrojnë në një vijë dhe fillojnë të hedhin kometën, pas 1,2,3 nise!



Detyra:

Bën një kometë dhe luan lojën bashkë me shokun.

Si punon:

Vetëm, me të gjithë grupin, në grup katërshe

Materiali:

- Gazetë
- Shirit ngjitës
- Varg
- Qese plastike
- Copa të vjetra rrobash
- Lapsa me ngjyra
- Gërshërë
- Shajak i zi, stilolaps me majë.



- **RAKETA NISËT** → Faqe 68



- **ÇFARË ËSHTË E KUQE?** → Faqe 30
- **PËSHPËRITJE E LEHTË** → Faqe 75

5 - DETYRA 6 NE PRAKTIKOJMË LOJËRAT TONA



45'

Detyra:


Praktikon lojërat që ke luajtur.

Si punon:

Vetëm, me të gjithë grupin,
me një shok

Materiali:

- Siç është përshkruar tek detyrat.




- **BËJMË ËMBËLSIRA** → Faqe 75
- **KUSH NGA JU MUNDËT?** → Faqe 71
- **KLLAPI** → Faqe 73
- **GURI RRUZULL** → Faqe 73
- **TË HEDHURIT E KOMETËS** → Faqe 77
- **RAKETA NISËT** → Faqe 68
- **SIMONI THOTË** → Faqe 68




- **ÇFARË ËSHTË E KUQE?** → Faqe 30
- **ÇFARË KA NDRYSHUAR?** → Faqe 71
- **MERIMANGA NË RRJET** → Faqe 73
- **PËSHPËRITJE E LEHTË** → Faqe 75

Ne Luajmë së BASHKU


6



SHËNIME



Ne luajmë së bashku



6 - DETYRA 1

TË PËRGATITURIT E FESTËS SË LOJËRAVE

HAPAT

1. Fëmijët rrinë në një rreth dhe përshkruajnë, diskutojnë fotografinë në kapitullin 6.
2. Mësuesi paraqet detyrën për organizimin e festës së lojërave. Ata diskutojnë rregullat bashkë. Mësuesi i përmbledh rregullat që fëmijët njohin. Më pas ai tregon rregullat në fletën e punës (→ Faqe 83) dhe i shpjegon ato. Rregullat janë ekspozuar në klasë.
3. Mësuesi shpjegon që në festë do të jenë 10 lojëra që do të luhen së bashku me prindërit. Të gjitha lojërat janë të renditura në tabelë. Fëmijët do të varin një tabelë në gjoks dhe do të shënojnë lojërat që kanë luajtur.
4. Fëmijët heqin tabelat dhe vendosin një shirit rreth tyre. Punojnë dyshe. Mësuesi shënon emrat në tabelë dhe i mbledh ato.



45'

Detyra:

Përgatit me mësuesin lojërat për festën. Mëson që të nevojiten rregulla që të luani bashkë.

Si punon:

Dyshe, në grupe dhe me gjithë klasën

Materiali:

- Gërshërë
- Tabelë për lojën
- Copa shiritash
- Materiale për lojërat që luhen



• **LOJA E PËRSHËNDETJEVE** → Faqe 10


• **RAKETA NISËT** → Faqe 68



• **MESAZHI I FSHEHTË** → Faqe 48
dhe/ose **KU ËSHTË THESARI?** → Faqe 15


Rregullat Për të punuar dhe luajtur së bashku

1




Mos lëndo të tjerët.

2




Kur keni përfunduar së luajturi apo punuari, vë gjithçka në vendin e vet.

3




Ndaji gjërat.

4




Lëri të tjerët të marrin pjesë.

5



Mos thyej gjëra.



Emri



1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
10									

6 - DETYRA 2

PROVA

HAPAT

1. Mësuesi u shpjegon fëmijëve se ata duhet t'i provojnë lojërat dhe këngët për festën e lojërave.
2. Më poshtë janë vetëm disa ide se çfarë elementesh mund të jenë pjesë e një performance të tillë.
 - "Më pëlqejnë kafshët", "Maska qesharake kafshësh", "Zërat e kafshëve", "Jam një kafshë" (→ kapitulli 1)
 - Program palestre për ndjenjat (→ kapitulli 3)
 - Këngë, p.sh. "Nëse je i lumtur" apo këngë të tjera në lidhje me ndjenjat (→ kapitulli 3)
 - Të luash role.
 - "Më shumë, më i gëzuar", "Le të bëjmë paqe" (→ kapitulli 3)
 - "Maska qesharake kafshësh" (→ kapitulli 1)
3. Lëroni vetes kohë për të praktikuar dhe përsërisni atë disa herë. Sigurohuni që çdo fëmijë ka një rol apo diçka për të performuar.
4. Mësuesi i kujton fëmijët për rregullat. Ai po ashtu kalon listën e gjërave (→ Faqe 86). Më pas fëmijët praktikojnë.



45'

Detyra:

Provoni performacën dhe mëson se cili do të jetë roli yt në lojën për festën.

Si punon:

Dyshe, në grupe dhe me të gjithë klasën

Materiali:

- Merre vesh lojën dhe performo zgjidhjen tënde.



• **GJARPRI MUZIKOR** → Faqe 32

• **RAKETA NISËT** → Faqe 68



• **KLLAPI** → Faqe 73

• **MIRUPAFSHIM TOP** → Faqe 58

LISTA e GJËRAVE




FOL me zë të LARTË.




FOL QARTË.



SHIKO FYTYRAT NË AUDIENCË.



**NËSE TREGON DIÇKA,
SIGUROHU QË GJITHKUSH E SHEH ATË.**



MOS JI I TURPShëm.

6 – DETYRA 3 NE PËRGATISIM FTESËN

HAPAT

1. Mësuesi paraqet detyrën e bërjes së ftesave. Ai gjithashtu e kalon programin me klasën.

a) **Mirë se vini.**

b) **Vizatim me dorë i çdo të ftuari.**

Prindërit dhe fëmijët vendosin duart mbi një fletë të madhe letre dhe lënë gjurmë aty. Më pas shkruajnë emrat e tyre në gjurmët e duarve mbi letër. Do të jetë një kujtim i këndshëm nga festa.

c) **Mikëpritja për prindërit dhe të shpjeguarit e FACE:** Mësuesi u uron mirëseardhjen prindërve dhe fëmijëve. Mësuesi u shpjegon se çfarë kanë bërë mirë fëmijët me FACE-n.

d) **Performanca e fëmijëve:** Fëmijët performojnë një këngë ose lojë me role, të cilën ata e kanë ushtruar.

e) **Luajmë së bashku.** Në fillim mësuesi, fëmijët dhe prindërit luajnë së bashku. Më pas secili fëmijë kalon nëpër lojën me stacione me prindërit e tij/saj.

f) **Lamtumira prindërve:** Përpara se prindërit të largohen, fëmijët dhe mësuesi i falënderojnë prindërit për ardhjen. Luhen disa lojë bashkë dhe më pas u thonë njëri-tjetrit mirupafshim.

2. Fëmijët ngjyrosin ftesat e tyre.



40'

Detyra:

Ngjyros ftesën, nje programin e lojës për festën.

Si punon:

Vetë dhe me të gjithë klasën

Materiali:

- Fletët e punës → Faqe 88
- Lapsa me ngjyra
- Materiale që kërkohen për lojërat dhe performancën



• **PËRSHËNDETJET E MARSIT** → Faqe 99

• **SALLATË FRUTASH** → Faqe 58
apo **KUSH NGA JU MUNDËT?** → Faqe 71



• **MESAZHI I FSHEHTË** → Faqe 48

• **KU ËSHTË THESARI?** → Faqe 15



FTESË NË festën e lojërave

Ju ftojme të vini në shkollë më

_____ (Data)

Nga _____ deri _____ (koha)

PROGRAMI

1

Mirëseardhje

2

Perfomancë nga fëmijët.

3

Luajmë së bashku.

4

Mirupafshim!

6 - Detyra 4 PRAKTIKOJMË (1)



45'

Detyra:

Praktikon të gjitha lojërat dhe shkon nëpër stacionet e lojërave në dyshe.

Si punon:

Dyshe dhe me të gjithë klasën

Materiali:

- Materiali e përshkruara tek loja.

HAPAT

- Mësuesi praktikon lojën me fëmijët. Ata luajnë në dyshe. Përdorin tabelën për të shënuar se çfarë kanë luajtur.
- Këtu është lista e lojërave dhe propozimet.

3

FUT TOPA NË KUTI

(kuti dhe 10 topa letre)

2

BËHU PASQYRA IME

(Nuk ka material)

1

TË SHKRUASH MBAS SHPINE

(Nuk ka material)

4

PISTA e VERBËR

(Karrige, shkumës etj.)

5

LOJË me ROLE
"SA MË SHUMË,
AQ MË ARGËTUESE"

6

SHQISAT e MIA

(3 gjëra për t'i prekur
dhe 3 për t'i mbajtur erë
dhe zgjidhjet)

7

I SHËNDETSHËM
DHE JO I
SHËNDETSHËM

(Kopjo pyetësin nga
4 – Detyra 3)

8

MUND TË BËJ muzikë

(Instrumentet e bëra
në kapitullin 5)

9

GURI RRUZULL

(Gurë të ngjyrosur)

10

SA LARG
FLUTURON KOMETA?

(Dy kometa)

6 - DETYRA 5 PRAKTIKOJMË (2)

HAPAT

1. Fëmijët duhet të kenë mjaftueshëm kohë për të praktikuar sërish performancat e tyre.
2. Mësuesi vendos se cilat lojëra duhet të praktikohen edhe një herë.
3. Mësuesi jep më tej sqarime nëse është e nevojshme. Bën po ashtu caktime rolesh për fëmijët p.sh. shpërndarja e tabelave me stacionet e lojës ose të shpjeguarit mysafirëve se duhet të vendosin duart e tyre me ngjyra mbi fletë për të lënë gjurmët në fillim të festës. etj.



45'

Detyra:

Provon sërish performacën dhe praktikon disa lojëra.

Si punon:

Dyshe, në grupe dhe me të gjithë klasën

Materiali:

- Gjithçka që duhet për prova dhe për lojërat që doni t'i praktikoni.



6 - DETYRË FAMILJARE 6

FESTA E LOJËRAVE: LUAJMË SË BASHKU

HAPAT

Programi mund të përmbajë si më poshtë:

1

Bërja e vizatimit të dorës për secilin të ftuar

Çdo prind dhe fëmijë që vjen në festë lë gjurmët e dorës së tij/saj mbi letër dhe shkruan emrin e tij/saj në atë formë.

2

Mirëseardhje për prindërit

Mësuesi së bashku me fëmijët u uron mirëseardhjen prindërve.

3

Performanca nga fëmijët

Fëmijët këndojnë dhe performojnë atë çfarë kanë praktikuar.

4

Fëmijët dhe prindërit luajnë lojëra

Luhet disa lojëra të njohjes me njëri-tjetrin. Fëmijët në fillim mund fillimisht t'i demonstrojnë dhe më pas ta luajnë bashkë me prindërit.

5

Paraqesin përreth lojën me stacione

Shpjegohet sërish se si funksionon loja me stacione. Duhet siguruar që të gjithë të kenë një tabelë.

6

Lamtumira prindërve

Falenderohen prindërit për pjesëmarrjen. Tregohen duart e vizatuara me ngjyra si simbol për këtë pjesëmarrje dhe luhet një lojë qetësuese përfundimtare në rreth.



120–180'

Detyra:

Festa e lojërave zhvillohet.

Si punon:

Dyshe, në grupe dhe me të gjithë miqtë

Materiali:

- Siç është përshkruar në disa detyra.



**ÇFARË KAM MËSUAR UNË
ÇFARË KEMI MËSUAR NE**

7

7 - DETYRA 1 NA PËLQEN TA LËVIZIM TRUPIN

HAPAT

1. Këngë për nxehje "Koka dhe krahët". Këndo këngën bashkë me fëmijët dhe bëj lëvizjet (teksti dhe muzika në faqen tjetër).
2. Fëmijët qëndrojnë në rreth.
3. Mësuesi fillon të paraqesë lëvizjet e trupit dhe fëmijët ndjekin lëvizjet. P.sh.
 - Të prekin këmbët me duar (pa përkulur gjunjët).
 - Të prekin shpatullën e majtë me gishtat e djathtë duke vendosur krahun përmbi kokë.
 - Të tendosin (tërheqin) muskujt.
 - Qëndrojnë në majën e gishtave dhe "kapin yjet".
 - Qëndrojnë në rreth, kapin duart e njëri-tjetrit dhe lëvizin në një drejtim. Përpiqen të ndërrojnë drejtim.
4. Fëmijët vazhdojnë dhe i paraqesin lëvizjet e tyre për të tjerët që vijnë.
5. Disa fëmijë pyeten se si ndihen pas lëvizjeve
6. Përsërit sërish këngën



15'

Detyra:

E mbani mend që lëvizja e trupit me shaka është e bukur.

Si punon:

Me të gjithë klasën

Materiali:


- Manjetofon ose kompjuter dhe internet për të dëgjuar këngën.
- Kënga "Koka dhe krahët"
www.youtube.com/watch?v=HA68Pyf7_Z8

Na pëlqen ta lëvizim trupin

KËNGA:

Koka dhe krahët

Koka, krahët, gjunjët, këmbët



KUR KËNDONI BËNI KËTO LËVIZJE.



Koka: Trego kokën tënde.

Krahët: Trego shpatullat.

Gjunjët: Trego gjunjët.


Këmbët: Trego majat e këmbëve.

Sytë: Trego sytë.

Veshët: Trego veshët.

Goja: Trego gojën.

Hunda: Trego hundën.



7 – DETYRA 2

TË VIZATUARIT E NJË ÇMIMI PËR TRUPIN TONË

HAPAT

1. Mësuesi nis një diskutim pse fëmijët e pëlqejnë trupin e tyre. Ata diskutojnë se çfarë mund të bëjnë dhe këto çështje i diskutojnë me ata që kanë afër.
2. Pas kësaj ata shkëmbejnë idetë e tyre. Atyre u jepet detyra që të vizatojnë çmimin në fletën e punës (brenda aktiviteteve të trupit). Mësuesi tregon që çmimi është për aktivitetet e trupit që fëmijët pëlqejnë më shumë.



Detyra:

Merr njohuri që një trup i shëndetshëm është i çmuar.

Si punon:

Me të gjithë grupin, dyshe, vetëm

Materiali:

- Fletët e punës → Faqe 97
- Lapsa me ngjyra



- **PËRPLAS SHUPLAKAT MBI DYSHEMË** → Faqe 56



- **KËNGË: KOKA DHE KRAHËT** → Faqe 95
- **DUART E NGROHTA TË DIELLIT** → Faqe 56

Të vizatuarit e një çmimi
për trupin tonë



7 - DETYRA 3

PIKTURA e KLASËS sonë

HAPAT

1. Fëmijët qëndrojnë në rreth. Mësuesi diskuton një "mozaik" me fëmijët. Ai mund të vërë copa të vogla letre në dysheme, për të demonstruar.
2. U paraqet qëllimin e të bërit një pikturë së bashku me klasën. Ai tregon që të gjithë do të bëjnë një copë të mozaikut.
3. Ai tregon një copë të thjeshtë letre dhe jep udhëzime: "Jeni të lirë ta bëni atë si t'ju pëlqejë. Këtu ka vetëm një rregull: Duhet të përdorni ngjyra dhe t'i vendosni ngjyrat në mënyrën që doni të pikturoni. Mos vizatoni objekte si një top apo kalë etj."
4. Fëmijët pikturojnë vetë. Mësuesi i shkruan emrat e fëmijëve në pjesën e pasme të pikturave.
5. Mësuesi dhe fëmijët mbledhin të gjithë pikturat në një pikturë të madhe. (Ndoshta, mbi dysheme). Bashkë diskutojnë se si duket piktura e madhe.
6. Mësuesi e gjen një hapësirë për të varur pikturën e madhe (nëse është e mundur)



45'

Detyra:

Realizon një pikturë të klasës. Kupton që je pjesë e një grupi të madh.

Si punon:

Me të gjithë grupin, vetëm

Materiali:

- Fletë të bardha letre (A4 apo më të vogla) për çdo fëmijë
- Ngjyra apo lapsa me ngjyra



• **KLLAPI** → Faqe 73

7 - DETYRA 4

KËSHTU PËRSHËNDESIN MARSIANËT

HAPAT

1. Fëmijët rrinë në rreth. Mësuesi mbledh ide në lidhje me mënyrat e përshëndetjeve të vendeve të tjera të botës. Nëse fëmijët nuk njohin forma të tjera, ai mund t'u paraqesë përshëndetjen "Wai" të Tajlandës: Shtrengon pëllëmbët e duarve së bashku përpara gjoksit dhe ul kokën.
2. Më pas mësuesi mbledh format e reja të përshëndetjeve nga fëmijët: "Si mund të përshëndesni ndryshe dikë? Si mendoni se përshëndesin Alienët?"
3. Më pas fëmijët ngarkohen me detyrën që të shkojnë dyshe dhe të shpikin forma të reja të përshëndetjeve duke imagjinuar që janë njerëz nga planeti Mars. Çdo dyshe mund të shpikë tri forma të reja përshëndetjeje.
4. Fëmijët ulen sërish në rreth. Dyshet ftohen në mes të rrethit të paraqesin "përshëndetjet nga Marsi". Çdo herë çiftet dalin në qendër të rrethit dhe përshëndesin njëri-tjetrin.



30'

Detyra:

Merr njohuri se ka forma të ndryshme përshëndetjeje në botë.

Si punon:

Në grup, dyshe

Materiali:

- Asgjë



• LOJA PËRSHËNDETËSE

Me duartrokitje, me qepalla dhe përçafime → Faqe 10



• KU ËSHTË THESARI? → Faqe 15

ose ÇFARË ËSHTË NDRYSHE? → Faqe 27

7 – DETYRË FAMILJARE 5 PËRSHTYPJET E PRINDËRVE TË MI

HAPAT

1. Mësuesi u paraqet fëmijëve detyrën. Ai u tregon atyre fletën e përshtypjes së prindërve dhe u shpjegon përse janë pyetur prindërit të bëjnë këtë gjë. P.sh.: "Në këtë vit shkollor ne bashkë kemi punuar shumë: Ju, prindërit tuaj dhe unë vetë. Disa nga prindërit tuaj erdhën në klasë dhe bënë gjëra bashkë me ne dhe disa të tjerë erdhën për të luajtur me ne. Tani, mund t'i pyesni ata nëse u ka pëlqyer kjo gjë dhe çfarë kanë pëlqyer më shumë nga kjo gjë."
2. Mësuesi u tregon fletët fëmijëve dhe ua shpërndan atyre. "Kur të shkoni në shtëpi, jepuni këto fletë prindërve tuaj. Mund t'i mbushni së bashku me ta. Prindërit mund të zgjedhin dhjetë deklaratat me të cilat pajtohen."
3. Sillini sërish fletët në shkollë.



30'

Detyra:

Prindërit japin përshtypjet për programin FACE dhe pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e shkollës. Ata e bëjnë këtë gjë me ju në shtëpi.

Si punon:

Vetëm, me prindërit e tu

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 101
- Lapsa me ngjyra



Përshtypjet e prindërve të mi



- FACE mu duk interesant.
- FACE ishte motivuese.
- FACE mu duk me shumë punë.
- FACE ishte shumë e dobishme për fëmijën tim.
- Mësimet e FACE mu dukën të gjalla.
- U kënaqa në festën e lojërave të FACE.
- Më pëlqeu të jem në shkollë me fëmijën tim.
- Më pëlqeu të punoj me mësuesin.
- FACE më ndihmoi të shoh se çfarë mund të bëjë fëmija im.
- FACE më ndihmoi të shoh forcën e çdo fëmije.
- Fëmija im u gëzua me mësimet e FACE.
- Kam dëgjuar shumë në shtëpi në lidhje me FACE.
- Fëmija im di tani më shumë lojëra dhe këngë.
- Fëmija im di kupton tashmë se për çfarë është i zoti.
- FACE kontribuoi në një atmosferë të mirë në klasë.
- FACE kontribuoi për një atmosferë të mirë prindërisht.
- FACE kontribuoi për një lidhje të mirë midis mësuesve dhe prindërve.



Choose 10
statements you
agree with

7 - DETYRA 6

ÇFARË MË PËLQEU DHE ÇFARË NUK MË PËLQEU

HAPAT

1. Mësuesi jep një pasqyrë të shkurtër në lidhje me aktivitetet që janë kryer.
2. Ai u tregon fëmijëve fletët e punës dhe u shpjegon kuptimin e fotove dhe simbolet për emocionet.
3. Fëmijët shohin fotot dhe vënë një fytyrë të qeshur për "Më pëlqeu aktiviteti", fytyrë neutrale "Më disi aktiviteti" dhe një fytyrë të trishtuar për "Nuk më pëlqeu shumë aktiviteti".
4. Mësuesi mbledh të gjitha fletët. Pas mësimit, gjen kohë që të marrë përshtypjet e çdo fëmije. Ideale është t'i thërrasë fëmijët njërin pas tjetrit dhe të flasë shkurtimisht në lidhje me arritjet e tyre. Fokusi i kësaj bisede mund të jetë përparësitë e fëmijëve dhe jo dobësitë dhe gabimet. Mësuesi mbush po ashtu një përshtypje pozitiv në fund të faqes.



25'

Detyra:

Mendon për aktivitetet që ke bërë dhe shpjegon se çfarë pëlqen dhe çfarë jo.

Si punon:

Vetëm

Materiali:

- Fletë pune → Faqe 103
- Lapsa me ngjyra






- Fëmijët zgjedhin për të luajtur një lojë që parapëlqejnë.



- Fëmijët e zgjedhin lojën nga FACE, që duan ta përsërisin. Mësuesi vendos se cilat lojë kanë për t'u luajtur. Në maksimum mund të luhen tri lojë.

Çfarë më pëlqeu dhe çfarë nuk më pëlqeu



Vizatimi

--	--	--

Këndimi dhe muzika

--	--	--

Të luajturit lojëra

--	--	--

Diskutimi

--	--	--

Të bërit e gjërave

--	--	--

.....

--	--	--

Përshtypjet e mësuesit tim

